



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. 20 / 2026
Datë: 06/03 / 2026

Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 3) të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, si dhe Rregullores Nr.04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për identifikimin dhe transferimin e pasurisë jo financiare ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, me këtë përbërje:
 - 1.1 . Bahri Beqiri, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve të Përgjithshme - kryesues;
 - 1.2 . Resul Jashari, Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative - anëtar;
 - 1.3 . Ilir Mazreku, Zyrtar i Lartë për Planifikim - anëtar.
2. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi ka për detyrë të realizojë identifikimin dhe transferimin e pasurisë jo financiare në bazë të funksioneve, kompetencave dhe nevojave organizative, si dhe të sigurojë shpërndarje të drejtë dhe funksionale të çdo pasurie që më herët ka qenë në pronësi dhe përdorim të Departamentit për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Anita KALANDERI

Sekretare e Përgjithshme

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit për Shërbime të Përgjithshme;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.